



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TÜRKIYE



UDHËZIMET E RISHIKUARA TË DG NEAR
PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQI
2021-2027

RAPORT VLERËSIMI I SITUATËS BAZË

ANEKSI 3

ANALIZA PËR
KOSOVËN



Funded by
the European Union



Ky studim u krye nga një ekip ekspertësh nën mbikëqyrjen e projektit EU TACSO 3.

Ekspertja drejtuese dhe autorja kryesore: Snježana Bokulić

Analistja e të dhënave dhe ekspertja e anketimit: Dr. Blerina Metanj Subashi

Autorët e Analizës për Vendet:

Natasha Mazari – Shqipëri

Kanita Kulić – Bosnje dhe Herzegovinë

Afërdita Pustina – Kosovë

Aleksandra Gligorović – Mali i Zi

Marija Armenski – Maqedonia e Veriut

Jelena Pajović van Reenen – Serbi

Özge Konuralp – Turqi

Drejtuesi i Ekipit EU TACSO – Richard Allen

Këshilltarët Ligjore

Dr. Ersida Teliti – Shqipëri

Selim Kulić – Bosnje dhe Herzegovinë

Milorad Marković MSci – Mali i Zi

Maja Atanasova – Maqedonia e Veriut

Dr. Robert Sepi – Serbi

Assoc. Prof. Dr. Ulaş Karan – Turqi

Redaktori: Jonathan Boulting

Beograd, Serbi, Maj 2023

<https://tacso.eu>

Hyrje

Analiza për Kosovën është një aneks i Udhëzimeve të DG NEAR për Mbështetjen e Shoqërisë Civile 2021–2027: Raport Vlerësimi i Situatës Bazës 2021.

Udhëzimet paraqesin rezultatet që aspiron të ketë mbështetja e BE për shoqërinë civile në rajonin e zgjerimit në këtë periudhë 7-vjeçare. Ky vlerësim ofron evidencë për situatën kundrejt treguesve të Udhëzimeve për 2021, që është viti i situatës bazë.

Ky aneks ofron një përmbledhje të evidencës për vlerësimin e situatës në Kosovë kundrejt secilit nga 59 treguesit që janë të përfshirë tek Udhëzimet. Ky aneks duhet të lexohet së bashku me raportin kryesor, i cili gjendet në faqen e internetit tacs.eu.

Metodologjia

Analiza e prezantuar në raportin kryesor dhe në anekset përkatëse janë bazuar në të dhëna të mbledhura nga burime parësore dhe dytësore. Kërkimi parësor përfshiu anketat me OSHC-të dhe me zyrtarët publik, si dhe analizën ligjore të ligjeve përkatëse. Burimet dytësore si raportet e prodhura nga OSHC-të, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, qeveria dhe të tjerë u rishikuan për të dhëna dhe informacion të rëndësishëm. Grumbullimi dhe analiza e të dhënave i referohet vitit 2021, i cili është viti i situatës bazë.

Anketa me zyrtarët publik u realizua nga 13 tetori deri me 22 nëntor 2022. Qëllimi i anketës ishte të mblidhte informacion mbi perspektivën mbi tregues të rëndësishëm specifik nga zyrtarë publik të përzgjedhur, të cilët në punën e tyre angazhohen më ngushtësisht me OSHC-të. Anketa konsistoi kryesisht me pyetje të mbyllura dhe ishte anonime. Për Kosovën, u morën 14 përgjigje nga institucionet publike.

Anketa me OSHC-të u realizua nga 26 shtatori deri me 18 tetor 2022. Anketa u qarkullua gjerësisht dhe mori 83 përgjigje të vlefshme nga Kosova. Anketa konsistoi kryesisht në pyetje të mbyllura.

Më shumë se gjysma e atyre që u përgjigjën, 67.5%, ishin zyrtarë të lartë në organizatë, kryesisht drejtorë ekzekutiv, menaxherë, anëtarë bordi, ose kryetarë. Përsa i përket kohës në organizatë, 61% e tyre kanë qenë me organizatën për tetë vite ose më shumë.

Më pak se gjysma e atyre që u përgjigjën, 45%, u identifikuan si gra; vetëm 1.2% nuk zgodhën një identifikim binar. Më shumë se katër të pestat e atyre që u përgjigjën, 88%, ishin 31 vjeç ose më shumë; 29% ishin me shumë se 51 vjeç.

Pak më shumë se një e katërta e atyre që u përgjigjën, 32.5%, u identifikuan që i përkasin një komuniteti minoriteti, ose grupi të marginalizuar. Nga këta që u identifikuan se i përkasin një grupi të tillë, 10% u identifikuan si persona me aftësi të kufizuara, 14% si Roma, Ashkali ose Egjiptian, dhe asnjë që ti përkasë komunitetit LGBTIQ+.

Më shumë se dy të tretat e OSHC-ve pjesëmarrëse, 80%, janë krijuar gjatë dy dekadave të fundit; pothuaj gjysma e tyre, 48%, u krijuan nga 2011–2021. Vetëm 3.7% e OSHC-ve pjesëmarrëse janë krijuar në 1990 ose më herët.

Pothuajse, të gjithë përgjigjet, 99%, ishin nga organizata të regjistruara formalisht. Gjysma e OSHC-ve pjesëmarrëse, 52%, ishin regjistruar si shoqata qytetarësh; 20% ishin fondacione.

Pjesa më e madhe e OSHC-ve që morën pjesë në anketë, 30%, punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, pasuar nga zhvillimi social-ekonomik, me 28%; arsimit, kërkimi dhe novacioni, 19%; dhe përfshirja sociale, transparenca dhe llogaridhënia, 15%. Përveç kësaj, 13% e OSHC-ve pjesëmarrëse punojnë në fushën e pjesëmarrjes publike në vendim-marrje dhe 13% në mobilitetin rinor, pasuar nga 12% që punojnë në ndërtim dhe zhvillim komuniteti dhe 12% në fushën e të drejtave të minoriteteve dhe mos-diskriminimit.

Më shumë se gjysma e OSHC-ve pjesëmarrëse, 59%, janë organizata të vogla me 1–10 staf me kohë të plotë ose të pjesshme dhe vullnetarë që punonin në kohën e anketimit. Vetëm 3% e OSHC-ve pjesëmarrëse angazhojnë 51 ose më shumë staf dhe vullnetarë. Mbi një e treta e OSHC-ve pjesëmarrëse, 38%, kanë një xhiro vjetore deri në 25,000 euro. 19% e tyre thanë se xhiroja vjetore e organizatës së tyre është midis 100,001 dhe 500,000 euro, ndërsa 13% thanë se xhiroja vjetore e organizatës së tyre kalon 500,000 euro.

Vlerësimi kundrejt treguesve

Të dhënat e mbledhura u përdorën për analizën e situatës në 2021 kundrejt secilit tregues. Për treguesit që kanë një vlerësim normativ, si përputhja me legjislacionin ose standardet, është përdorur sistemi i mëposhtëm i dritës së semaforit për të dhënë një udhëzim të shpejtë vizual:

5 – plotëson të gjithë standardet

4 – plotëson shumicën e standardeve

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

2 – plotëson standardet minimalisht

1 – nuk i plotëson standardet

Ky vlerësim u aplikua për treguesit ku vlerësimi dukej se kishte kuptim.

Treguesit e mbetur nuk kanë standard normativ, por tregojnë trendin vit-pas-viti. Raportet e ardhshme të vlerësimit do të ofrojnë vlera krahasuese kundrejt situatës bazë në 2021.



Objektivi Specifik 1

Ka një mjedis mundësues për shoqërinë civile për të realizuar aktivitetet e saj.

OS 1.1. Të gjithë individët dhe subjektet juridike në rajonin e zgjerimit mund të krijojnë, t'i bashkohen dhe të marrin pjesë në organizatat jo-formale dhe/ose të regjistruara, si dhe mund të mblidhen dhe të shprehen lirisht.

Treguesi 1.1.a: Masa në të cilën legjislacioni kombëtar përkatës mundëson që:

- Shoqatat mund të krijohen ose regjistrohen pa asnjë lloj diskriminimi;
- Nuk ka kufizime të paligjshme për gamën e aktiviteteve ose arritjen e objektivave të tyre;
- Shpërndarja e tyre mund të ndodhë vetëm pas një vendimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme;
- Nuk ka kufizime të paligjshme për lirinë e tubimit paqësor;
- Liria e shprehjes ushtrohet nga të gjithë dhe nuk ka kufizime të paligjshme.

4 – plotëson shumicën e standardeve

Në Kosovë, e drejta për **lirinë e organizimit** është vendosur me Nenin 44 të Kushtetutës¹. Ajo përfshin të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. Përveç kësaj, parashikimet ligjore në Ligjin mbi Lirinë e Organizimit në OJF² mbi arsyet lidhur me krijimin ose regjistrimin e shoqatave janë në përputhje me standardet dhe parimet ndërkombëtare, përderisa prej disa vitesh nuk janë raportuar probleme të mëdha rreth regjistrimit ose krijimit të OJQ-ve as në raportet e brendshme dhe as në ato ndërkombëtare.

Mbyllja e pavullnetshme e një shoqate, e cila mund të marrë formën e shpërndarjes ose ndalimit, mund të ndodhë pas një vendimi të një gjykate të pavarur dhe të paanshme. Sidoqoftë, arsyet për kufizimet në **lirinë e tubimit** duhet të përcaktohen më qartë, lidhur me tubimet paqësore.

Neni 8 i Ligjit “Për tubimet publike”³ përcakton se një tubim publik paqësor mund të ndalohe kur ka “arsye të konsiderueshme që tubimi do të mund të përdorej për dhunë” ose “nxitjen e dhunës ose urrejtjes”. Për arsye të paqartësisë, terma si “rrezik real” dhe “arsye të konsiderueshme” duhet të qartësohen më mirë në praktikën ligjore. Nëse nuk ka konsensus lidhur me kuptimin e këtyre termave, do të ishte e dobishme të përfshihen përkufizime shtesë në ligj për qartësimin se kur autoritetet mund të vendosin për ndalimin e një tubimi. Prandaj, ligji që rregullon lirinë e tubimit paqësor ka kufizime të ndryshme të cilat janë ndërhyrje në të drejtën për lirinë e tubimit. Sipas Nenit 4 të ligjit të mësipërm⁴, objektivat përfshijnë: a) ruajtjen e rendit, paqes dhe sigurisë publike, b) mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njerëzve të tjerë, c) mbrojtjen e moralit dhe shëndetit publik. Sidoqoftë, Ligji vendos një kufizim më të rreptë duke vendosur që “e drejta e pjesëmarrjes dhe e fjalimit në tubimet publike ndalohe në rastet kur tubimet publike shërbejnë për të thirrur apo nxitur, dhunën, urrejtjen ndërnacionale, religjioze, apo nxitje të tjera të ndaluara me ligj” dhe ndalon tubimet publike kur nuk ka leje nga policia⁵. Sidoqoftë, duhet përmendur se janë inicuar amendamente të Ligjit dhe ka kaluar leximi i parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës⁶.

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 44, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

2 Ligji No. 06/L-43 Mbi Lirinë e Organizimit në OJF, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>

3 Ligji No. 03/L-118 Për Tubimet Publike, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2633>

4 Ligji No. 03/L-118 Për Tubimet Publike, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2633>

5 Ligji No. 03/L-118 Për Tubimet Publike, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2633>

6 Draft Ligji No. 03/L-118 Për Tubimet Publike, në: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftLigji=406>

Kufizimet në **lirinë e shprehjes** janë përpjestimore dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike kur ato janë në përputhje me Standardet e fundit Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe rekomandimet dhe standardet e Këshillit të Evropës lidhur me gjuhën e urrejtjes. Në nivel kushtetues⁷, standardi për kufizime të tilla rregullohet nga Neni 40 paragrafi 2, që kërkon plotësimin kumulativ të kushteve të mëposhtme: a)një kufizim është vendosur me ligj, b)një kufizim është i domosdoshëm për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës, dhe c)një kufizim synon të parandalojë dhunën në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

OS 1.2. Autoritetet publike mbrojnë OSHC-të nga ndërhyrjet dhe sulmet dhe repektojnë të drejtën e tyre të privatësisë.

Treguesi 1.2.a: Masën në të cilën OSHC-të kanë mundësinë e një ndërhyrje efektive për të sfiduar ose kërkuar rishikimin e vendimeve që prekin ushtrimin e të drejtave të tyre.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

Sipas Nenit 43 të Ligjit “Për lirinë e organizimit në OJQ”⁸, është përcaktuar se “OJQ-ja që nuk pajtohet me vendimet e Departamentit të Regjistrimit të OJQ-ve, që kanë të bëjnë, por nuk kufizohen në çështjet e mos-regjistrimit, shpërbërjes, çregjistrimit, ose kundër mosveprimit administrativ, ka të drejtë për të kundërshtuar ose kërkuar rishikimin e vendimeve, veprimeve apo mosveprimeve të Departamentit dhe institucioneve publike, duke përfshirë edhe të drejtën për të parashtruar padi në gjykatën kompetente për çështjet administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, në pajtim me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrativ”.⁹

Një OJQ mund të kërkojë rishikimin e vendimit që prek ushtrimin e të drejtave të saj, përveç çështjeve të lidhura me jo-regjistrimin, shpërndarjen ose çregjistrimin, ose kundër lëshimeve administrative. Fusha e një të drejte të tillë apelimi përfshin të drejtën për padi brenda 30 ditëve në gjykatën kompetente për rishikimin e çështjeve administrative.¹⁰

Sidoqoftë, Neni 18 i Udhëzimit Administrativ QRK - Nr. 02/2014 Për Regjistrimin dhe Funksionimin e OJQ¹¹, mundëson Departamentin e OJQ-ve të pezullojnë aktivitetin e një OJQ-je. Apelimi kundër një vendimi të tillë shqyrtohet nga i njëjti autoritet që ka marrë vendimin (një Komision brenda Departamentit të OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike).¹² Duke marrë në konsideratë se vendime të tilla duhet të merren nga një autoritet i pavarur, ky element i Nenit konsiderohet që nuk është në përputhje me rregullimin ligjor dhe kushtetues të Republikës së Kosovës ose me të drejtën ndërkombëtare.

Bazuar në anketën e OSHC-ve, 12.5% e të anketuarve thanë se në 2021 autoritetet qeveritare morën vendime mbi organizatën e tyre që kanë ndikuar negativisht mbi aftësinë e tyre për të ushtruar të drejtat. Shembujt e këtyre vendimeve të dhëna nga të anketuarit në anketë përfshijnë nxjerrja nga hapësirat publike komunale, mungesa e mbështetjes nga autoritetet e qeverisjes vendore bazuar në agjenda politike për OSHC-të që operojnë në komunat në veri të Kosovës, si dhe mos-dhënia e hapësirave publike komunale për projektet (me BE) për të cilat ka pasur marrëveshje paraprake.

Vetëm 16.7% e OSHC-ve kishin mundësi të sfidonin efektisht vendime të tilla nëpërmjet kanaleve zyrtare, juridike dhe administrative.

7 Kushtetuta e Kosovës, 2008, Neni 40, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

8 Ligji no. 06/L-43 Mbi Lirinë e Organizimit në OJF, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>

9 Ligji no. 06/L-43 Mbi Lirinë e Organizimit në OJF, Neni 43, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>

10 Ligji no. 06/L-43 Mbi Lirinë e Organizimit në OJF, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>

11 Udhëzimit Administrativ QRK - Nr. 02/2014 Për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare, Neni 18, në: <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/42849C56-2EA4-4D79-9175-40848137EE39.pdf>

12 Udhëzimit Administrativ QRK - Nr. 02/2014 Për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare, Neni 18, në: <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/42849C56-2EA4-4D79-9175-40848137EE39.pdf>

Treguesi 1.2.b: Masa në të cilën OSHC-të janë të mbrojtura me ligj kundrejt kërcënimeve, sulmeve, ngacmimeve ligjore dhe trajtimit diskriminues, në veçanti:

- Kërcënimet përfshirë intimidimin, ngacmimin, shpifjen, si dhe gjuhën e urrejtjes, fizikisht dhe online;
- Sulmet përfshirë aktet e dhunës, abuzimit fizik, kontrollit dhe dëmtimit të pronës;
- Ngacmimi juridik përfshirë arrestimin ose ndalimin arbitrar, ndërhyrjen e paligjshme në komunikime, abuzimin me procedimet dhe kërcënimet penale, civile dhe administrative;
- Trajtimi diskriminues përfshirë kërkesat jo-proporcionale të raportimit për OSHC-të.

4 – plotëson shumicën e standardeve

Kodi Penal i Kosovës¹³ ofron mbrojtje kundër kërcënimeve ndaj organizatave ndërkombëtare, megjithatë kërcënimet kundër OSHC-ve në mënyrë specifike nuk janë përcaktuar në ligj. Më tej, Kodi ofron mbrojtje vetëm lidhur me sulmet kundër organizatave ndërkombëtare. Sulmet kundër OSHC-ve nuk janë përcaktuar në ligj. Më tej, Ligji nuk ofron mbrojtje për OSHC-të nga arrestimi ose ndalimi arbitrar, ose mbrojtje specifike për OSHC-të nga ndërhyrja në komunikimet e tyre.

Nuk ka ndonjë ligj që mbron OSHC-të nga abuzimi me procedimet penale, civile ose administrative. Një farë veprimi ligjor, shpesh i referuar si padia SLAPP (Strategic Lawsuit Against Public Participation/ Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike), përfaqëson një kërcënim të konsiderueshëm për debatin publik dhe lirinë e shprehjes. Një çështje e kohëve të fundit në Kosovë përfshiu aktivisten për mjedisin Shpresa Loshaj, e cila u përball me një padi SLAPP për shkak të aktivizmit të saj kundër hidrocentraleve në Luginën e Deçanit.

Mbrojtja formale ligjore që aplikohet për OSHC-të në Kosovë ndaj kërcënime, sulmeve, ngacmimeve juridike dhe trajtimit diskriminues është në përputhje me shumicën e standardeve të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Më specifikisht, Neni 13 i Ligjit "Për lirinë e organizimit" ofron garancitë e mëposhtme:

- a) OJQ ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga institucionet publike;
- b) Institucionet publike mbështesin dhe nxitin veprimtarinë e OJQ-ve;
- c) Institucionet publike trajtojnë OJQ-të me respekt të plotë, barazi dhe mos diskriminim;
- d) Institucionet publike krijojnë mjedis të përshtatshëm dhe zbatojnë praktika të mira ku OJQ-ja mund të veprojë në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e saj;
- e) Institucionet publike mbrojnë OJQ-në nga ndërhyrja e palëve të treta;
- f) Institucionet publike nuk ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë e OJQ-së dhe personave që ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e organizimit;
- g) Institucionet publike bëjnë publike të gjitha format e bashkëpunimit dhe përkrahjes së OJQ-ve.

Treguesi 1.2.c: Pjesa e OSHC-ve që operojnë efektivisht, pa kërcënime, sulme, ngacmime juridike dhe trajtim diskriminues, në kuptimin e:

- Numri i ankesave lidhur me mungesën e mbrojtjes për OSHC-të;
- Numrin e sulmeve mbi OSHC-të dhe anëtarët e tyre;
- Numrin e rasteve të dëmtimit të pronës;
- Numrin e rasteve të trajtimit diskriminues në raportim;
- Numrin e rasteve kur zyrat e OSHC-ve janë kontrolluar në mënyrë të paligjshme, duke ju nënshtruar inspektimeve;
- Numrin e rasteve të ndërhyrjes në komunikimet e OSHC-ve.

13 Kodi No. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës Kosovës, në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3F-CD.pdf>

Bazuar në anketën e OSHC-ve, 83% thanë se organizata e tyre ose anëtarët e saj nuk kanë qenë subjekt i kërcënimeve apo sulmeve fizike. Njëkohësisht, 12% thanë se organizata, anëtarët, ose të dyja kanë qenë subjekt i kërcënimeve apo sulmeve fizike.

87% e të anketuarve thanë se organizata ose anëtarët e saj nuk kanë bërë ndonjë ankesë zyrtare sepse atyre ju është mohuar mbrojtja nga kërcënimet ose sulmet fizike, kurse 8% thanë se kanë bërë.

Në mënyrë të ngjashme, 89% thanë se organizata nuk ka pasur dëmtim të pronës si pjesë e kërcënimeve ose sulmeve fizike kundër tyre, ndërsa 6% thanë se kanë pasur.

Përsa i përket kërkesave nga autoritetet për të dorëzuar raporte të tepruara dhe të pajustificuara që çojnë në diskriminim të organizatës, 89% u përgjigjën se nuk ju është kërkuara, ndërsa 6% u përgjigjën se ju është kërkuar.

Pyetjes nëse zyrat e organizatës kanë qenë subjekt i kontrolleve të paligjshme, 93% u përgjigjën që nuk kanë qenë. Në mënyrë të ngjashme, pyetjes lidhur me inspektimet e paligjshme, 95% u përgjigjën se nuk kanë qenë subjekt. Lidhur me pyetjen nëse autoritetet kanë ndërhyrë në komunikimet e organizatës, 89% u përgjigjën se nuk kanë qenë subjekt i ndërhyrjes, dhe 6% thanë se kanë qenë subjekt. Midis përgjigjeve pozitive ishin rastet kur autoritetet këshilluan që një aktivitet nuk duhet të zhvillohej.

OS 1.3. Masat e përdorura për të luftuar ekstremizmin, terrorizmin, pastrimin e parave, ose korrupsionin janë të targetuara dhe proporcionale, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezikun, dhe respektojnë standardet e të drejtave të njeriut mbi lirine e organizimit, tubimit dhe shprehjes.

Treguesi 1.3.a: Masa në të cilën ligjet për të luftuar ekstremizmin, terrorizmin, pastrimin e parave, ose korrupsionin nuk kufizojnë aktivitetet legjitime të OSHC-ve.

4 – plotëson shumicën e standardeve

Nuk ka ndonjë nen specifik në ligjet që luftojnë ekstremizmin, terrorizmin, pastrimin e parave dhe korrupsionin që kufizon ndonjë nga aktivitetet e OSHC-ve. Sifoqoftë, OSHC-të janë subjekt i mbikqyrjes dhe kontrollit nga organet qeveritare lidhur me masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kuadri ligjor në Kosovë, sikurse në pak vende të tjera, nuk është plotësisht në përputhje me rekomandimet e Task Forcës për Veprim Financiar (Financial Action Task Force - FATF), dhe vendos kërkesa shtesë, barrë për OSHC-të (Kosova, Shqipëria, BeH).¹⁴

Përsa i përket Kosovës, në kuadrin e një studimi rajonal, del se legjislacioni mbi masat kundër pastrimit të parave/financimit të terrorizmit konsiderohet problematik për OSHC-të, sepse nuk reflekton natyrën e sektorit, mund të shkaktojë vështirësi në regjistrim, dhe mund të keqpërdoret, duke kërcënuar veprimtarinë legjitime të OSHC-ve. Të dyja, pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit janë vepra penale në Kosovë.

Treguesi 1.3.b: Pjesa e OSHC-ve, aftësia e të cilave, për të ndërmarrë aktivitete legjitime nuk është kufizuar nga zbatimi i ligjeve për luftën kundër ekstremizmit, terrorizmit, pastrimit të parave dhe korrupsionin, vecanërisht nga:

- Ngacmimi juridik për lidhjen e tyre të supozuar me ekstremizmin, terrorizmin, pastrimin e parave, dhe korrupsionin;
- Kufizimet diskriminuese mbi financimin,
- Autoritetet ose bankat që parandalojnë ata të hapin llogari bankare, dergojnë ose marrin para.

¹⁴ Western Balkan 2020 – Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development: https://www.balkancsd.net/novo/ep-content/uploads/2021/07/94-5-Regional-Monitoring-Matrix-Report-2020_FINAL.pdf

Pyetjes nëse organizata ose anëtarët e saj kanë qenë subjekt i ngacmimit juridik për lidhje të supozuara me ekstremizmin, terrorizmin, pastrimin e parave ose korrupsionin, 95% e OSHC-ve u përgjigjën 'jo', kurse 2% u përgjigjën 'po'. Pyetjes nëse organizata ka qenë subjekt i praktikave diskriminuese për shkak të marrjes së fondeve nga një burim specifik, 93% u përgjigjën 'jo', ndërsa 4% u përgjigjën 'po'.

Pyetjes nëse organizata është parandaluar nga autoritetet qeveritare ose bankat për të hapur një llogari bankare, dërgimin ose marrjen e parave, 87% u përgjigjën 'jo', ndërsa 8% u përgjigjën 'po'. Këto përgjigje (8%) ju përkasin rasteve individuale dhe nuk përbëjnë një kufizim formal për/kundër hapjes së një llogarie bankare që mund të verifikohet.

OS 1.4. Autoritetet publike trajtojnë të gjithë OSHC-të në mënyrë të barabartë lidhur me operimin e tyre dhe njësoj si subjektet e tjera (si bizneset për shembull).

Treguesi 1.4.a: Masa në të cilën Ligjet (1) nuk ju kërkojnë OSHC-ve të dorëzojnë më shumë raporte dhe informacion dhe (2) nuk i bëjnë OSHC-të subjekt të më shumë inspektimeve dhe sanksioneve se sa subjektet e biznesit, ndërkohë që çdo gjë tjetër është e barabartë.

5 – plotëson të gjithë standardet

Ligji "Për lirinë e organizimit në OJQ-të", përveç detyrimeve financiare dhe të raportimit për OJQ-të me statusin e përfuturit publik, si dhe kërkesat lidhur me procesin e regjistrimit, nuk vendos ndonjë barrë tjetër mbi OJQ-të.

Ndërkohë që Ligji No. 06/L-016 për Kompanitë Tregëtare, që mbulon bizneset, detyron këto kompani të japin të dhëna, informacion dhe raporte për një sërë procedurash dhe aktiviteteve si regjistrimi, organizimi i brendshëm, ndryshimi/korrigjimi dhe plotësimi i të dhënave, kërkesa për bashkimin ose ndarjen e bizneseve, regjistrimin, format e kontributeve, bashkëpronësinë, raportimin financiar, auditimin, etj.

OJQ-të janë subjekt i inspektimit nga Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Banka Qendrore e Kosovës, dhe mund të kenë sanksione për shkelje të ndryshme. Një listë e detyrimeve specifike për OSHC-të jepet në Nenin 29 të Ligjit no. 05/l-096 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit'.¹⁵

Në përgjithësi, nuk duket që OJQ-të janë më shumë se sa bizneset subjekt i inspektimeve apo sanksioneve. Për shkak të natyrës specifike të operimit të tyre, detyrimet e referuar më lart për OJQ-të janë regulluar në mënyrë më të strukturuar në Ligjin Për Lirinë e Organizimit në OJQ-të, ndërsa një pjesë e tyre edhe në Ligjin 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit', bazuar në lidhjen e aktivitetit të tyre (OJQ-ve) me biznese të ndryshme. Midis këtyre detyrimeve është përfshirë kërkesa që, përveçse në rrethana të kufizuara, të gjithë të ardhurat dhe shpenzimet e OJQ-ve duhet të kalojnë nëpërmjet bankave dhe institucioneve financiare të licensuara nga BQK, nëpërmjet llogarive bankare të hapura për OJQ-të.

OS 1.5. Autoritetet publike qendrore dhe/ose lokale kanë politika dhe rregulla mundësuese për organizatat e vogla komunitare dhe iniciativat qytetare (organizatat grass-roots).

Treguesi 1.5.a: Organizatat e vogla/lokale komunitare dhe iniciativat qytetare lejohen të operojnë ligjërisht pa u regjistruar.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

¹⁵ Ligjit no. 05/l-096 'Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit' në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>

Kuadri ligjor në Kosovë nuk njeh kategorinë e organizatave me bazë komunitare. Sidoqoftë, përderisa ushtrimi i lirisë së organizimit pa nevojën e regjistrimit është një e drejtë kushtetuese, dhe e përcaktuar nëpërmjet legjislacionit primar dhe sekondar, çdo njeri mund të krijojë një organizatë, përfshirë një organizatë me bazë komunitare. Megjithatë nuk ka raportime për kufizime në funksionimin e organizatave të peregjistruara, shumica e donatorëve lokal (përfshirë institucionet qendrore dhe lokale) dhe donatorët ndërkombëtar nuk japin fonde për organizatat e peregjistruara. Në Janar 2017, Ministria e Administratës Publike inicjoi Sistemin Elektronik të Regjistrimit për OJQ-të¹⁶, për të lehtësuar procesin e regjistrimit të thjeshtuar dhe të lehtë të OJQ-ve. Sistemi ofron të njëjtat shërbime sikurse Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve. Në Kosovë, të gjithë organizatat, pavarësisht madhësisë, duhet të regjistrohen formalisht në mënyrë që të operojnë me aktivitetet e tyre, si për shembull të aplikojnë për fonde.

Treguesi 1.5.b: Para ligjit, organizatat e vogla komunitare dhe iniciativat qytetare të peregjistruara gëzojnë të njëjtën të drejtë të pjesëmarrjes në vendim-marrje sikurse OSHC-të e regjistruara.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

Në 2013, Qeveria e Kosovës aprovoi për herë të parë Strategjinë e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile, dokument që përfshin parimet kryesore dhe mënyrat e përfshirjes së OSHC-ve në vendim-marrje. Strategjia e fundit në këtë fushë është adoptuar në 2019 dhe mbulon periudhën 2019 - 2023.¹⁷ Konsultimi publik është një detyrim ligjor dhe rregullator që rrjedh jo vetëm nga Rregullorja e Punës së Qeverisë¹⁸ (Neni 32), por edhe nga Plani Kombëtar për Anëtarësimin e Kosovës në inisiativën Partneriteti për Qeverisje të Hapur. Të gjithë palët e interesuara mund të marrin pjesë në konsultimet publike, si organizatat e shoqërisë civile por edhe qytetarët e zakonshëm. Rregullorja mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik (No. 05/2016) është adoptuar në 2016. Neni 68 i Ligjit No 03/L-040 Mbi Vetë-Qeverisjen Lokale garanton pjesëmarrjen në vendim-marrjen publike në nivel lokal.¹⁹

Në Kosovë, pavarësisht nga shumë iniciativa legjislative dhe hapësirat për kontribut nga OSHC-të, vetëm OSHC-të e regjistruara konsiderohen si palë zyrtare në pjesëmarrjen formale në vendim-marrje. Për shembull, vetëm një OSHC e regjistruar mund të bëhet anëtare e Këshillit për Bashkëpunim midis Shoqërisë Civile dhe Qeverisë.

OS 1.6. Të gjithë OSHC-të janë të lira të kërkojnë dhe të marrin fonde.

Treguesi 1.6.a: Masa në të cilën ligjet lejojnë OSHC-të të kërkojnë një gamë të gjerë financimi, përfshirë nga jashtë vendit, pa kufizime të pajustificuara, lidhur me:

- Donacionet në para apo në natyrë nga të gjithë burimet;
- Financimi nga institucionet publike vendase;
- Financimi nga donatorët institucional, korporativ apo individual;
- Financimi nga qeveritë e huaja apo agjensitë shumë-palëshe.

5 – plotëson të gjithë standardet

Kërkesat e Ligjit për Lirinë e Organizimit në OJQ-të mund të konsiderohen si masa për të krijuar një hapësirë të gjërë lidhur me operimin e organizatave jo-qeveritare në Kosovë. Ato gjithashtu përmendin burimet e financimit të OJQ-ve, përfshirë donacionet, te ardhurat nga sigurimet, letrat me vlerë,

16 Regjistri Elektronik i OJQ-të: <https://ojq.rks-gov.net/Regjistruhu.aspx>

17 Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023, në: <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Strategjia%20ne%20tri%20qjuhe.pdf>

18 Rregullore e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës no. 09/2011, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/07/RREGULLORE-E-PUNES-SE-QEVERISE-SE-REPUBLIKES-SE-KOSOVES-NR-09-2011.pdf>

19 Neni 58, Ligji No. 03/L-040 Mbi Vetë-Qeverisjen Lokale në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

trashëgimitë, anëtarësia, dhuratat, grantet, pasuritë e luajtshme dhe të paluejtshme, të ardhurat nga fondet e investuara, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga aktivitetet e ligjshme të një OJQ-je me pasuritë dhe mjetet e saj. Kështu, burimet e OJQ-ve në Kosovë janë të shumta dhe, si të tilla, mund të konsiderohen në përputhje me praktikën e vendeve në rajon dhe më tej.²⁰

Rregullorja mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të përfshin parimin e trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit kundrejt aplikantëve si dhe përfshirjen e përfituesve të të gjithë gjinive si parime udhëzuese për zbatimin e tyre, sikurse është theksuar në Nenin 4, paragrafi 1.2.²¹

Treguesi 1.6.b: Pjesa e OSHC-ve që kanë akses në një gamë të gjërë financimi pa ndërhyrjen e pajustificuar të qeverisë.

Lidhur me çështjen nëse ndonjë ndërhyrje e pajustificuar qeveritare (audit arbitrar, kërkesë për tu regjistruar si një aktor i huaj) ka penguar organizatën e tyre për të aksesuar ndonjë lloj financimi, 79% e OSHC-ve u përgjigjën negativisht, ndërsa 21% u përgjigjën se ata nuk dinin rreth ndonjë veprimi të tillë.

OS 1.7. Në përfituesit e IPA, ekziston mbështetja publike financiare dhe jo-financiare për OSHC-të dhe ajo ofrohet në një mënyrë transparente, të përgjegjshme, të drejtë dhe jo-diskriminuese.

Treguesi 1.7.a: Niveli i financimit publik për OSHC-të dhe shoqatat është artikuluar qartësisht në ligjet dhe rregulloret, gjithashtu të drejtat dhe detyrimet e institucioneve shtetërore përgjegjëse për vendosjen dhe rishikimin e nivelit të financimit publik janë përcaktuar qartësisht në Ligj.

4 – plotëson shumicën e standardeve

Legjislacioni përkatës ka përcaktuar që çdo ofrues i mbështetjes financiare publike (institucionet qendrore ose lokale) duhet të përfshijnë një mbështetje të tillë financiare në kuadrin e zërave të veçanta buxhetore. Kjo do të thotë që shumica e mbështetjes financiare publike për projektet dhe programet e OJQ-ve duhet planifikuar në procesin e përgatitjes së buxhetit vjetor të Qeverisë, ose të buxhetit të ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike në rastet kur këto institucione nuk janë organizata buxhetore (për shembull, ndërmarrjet publike, fondet e pavaruara ose institucionet e ngjashme).

Kur përcaktohet numri i projekteve dhe programeve për t'u financuar, ofruesi i mbështetjes financiare publike duhet të marrë në konsideratë shumën e fondeve në dispozicion, të aprovuar në kuadrin e buxhetit të vitit në vazhdim, dedikuar për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve.

Siqdoqoftë, niveli i financimit publik nuk është artikuluar qartë në legjislacion. Po ashtu, duhet të merren në konsideratë kapacitetet institucionale për të monitoruar zbatimin e projekteve. Rregullorja²² e aprovuar nga Ministria e Financave është kriteri i vetëm për tu zbatuar, ndërsa, në termat e mundësisë së ofrimit të financimit nga organizatat buxhetore, mbështetjet akoma një model i decentralizuar, ku institucionet, bazuar në fushat e tyre prioritare përcaktojnë edhe nivelin e mbështetjes financiare.

20 Neni 35 pjesa 1 e Ligjit mbi Lirinë e Organizimit në OJF, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>

21 Rregullorja MF - Nr - 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik në OJQ-të në: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/2018_rregullorja_MF_Nr_042016_per_perkrahe_te_OJQve_dhe_manuali.pdf

22 Rregullorja MF - Nr - 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik në OJQ-të në: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/2018_rregullorja_MF_Nr_042016_per_perkrahe_te_OJQve_dhe_manuali.pdf

Treguesi 1.7.b: Përqindja e buxhetit publik e disbursuar në vit për OSHC-të.

Buxheti total i Qeverisë së Kosovës për vitin 2021 ishte 2,626,300,000 euro²³. Raporti mbi financimin publik të OSHC-ve tregon 29,768,569.52 euro²⁴ si financim për OSHC-të. Sidoqoftë, kjo shifër është subjekt interpretimi, sepse ajo përfshin paketën e emergjencës për COVID-19 dhe të gjithë financimet e tjera për ofrimin e shërbimeve për qeverinë nga OSHC-të, si trajnimet për institucionet publike, etj. Deri në 35% e këtij financimi ka shkuar për projekte të ndryshme kapitale, komunitetet fetare, këshillat e vepërimit lokal, federatat dhe klubet sportive dhe institucionet e tjera, përfshirë shërbimet sociale edukative dhe të trajnimit.

Treguesi 1.7.c: Masa në të cilën kërkesat ligjore që rregullojnë dhënien e fondeve publike për OSHC-të sigurojnë që:

- Kriteret e financimit janë përcaktuar qartë, janë objektivë dhe të njoftuar publikisht;
- Vlerësimi i propozimeve është i qartë dhe paanshëm;
- Konflikti i interesit është rregulluar qartësisht;
- Kërkesat e raportimit janë të qarta dhe proporcionale.

4 – plotëson shumicën e standardeve

Vitet e fundit, Kosova ka bërë përparim të dukshëm në përcaktimin e modelit të financimit për projektet dhe programet e OJQ-ve. Rregullorja No 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve²⁵, ka vendosur rregullat standarde për transparencën, sipas të cilit financimi publik për OJQ-të duhet të bëhet në mënyrë të organizuar dhe bazuar në kritere të paracaktuara dhe konkurruese. Përveç kësaj, ajo ofron një qasje të harmonizuar për të gjithë mundësitë e financimit publik lidhur me financimin publik të OJQ-ve.²⁶ Për më tepër, Ligji mbi Menaxhimin Financiar Publik thekson se rregullat për grantet, subvencionet dhe mbështetjet e ofruara nga autoritetet publike duhet të nxirren nga Ministria e Financave, ku përcaktohen kriteret për shpërndarjen e tyre, metodën e përzgjedhjes së përfituesve, shumën, etj. Rregullorja gjithashtu përmban një set formash që janë të aplikueshme në të gjitha thirrjet për financim publik. Ajo gjithashtu specifikon rregullat për Komisionin e Vlerësimit nën Kapitullin V, i cili rregullon në detaje kriteret dhe procedurat për vlerësimin e aplikimeve për financim. Në 2021, ishte e nevojshme që Rregullorja të rishikohej për të adresuar çështjet e konfliktit të mundshëm të interesit.

Treguesi 1.7.d: Qeveria qëndrore bën informimin mbi grantet publike që është mjaftueshëm i detajuar që të mundësojë identifikimin e granteve individuale.

4 – plotëson shumicën e standardeve

Institucionet publike në Kosovë publikojnë thirrjet e tyre në faqet e tyre të internetit dhe mediat sociale. Sidoqoftë, do të ishte ndihmuese nëse qeveria do të publikonte të gjitha thirrjet në një vend.

Përveç kësaj, të dhëna të detajuara mbi grantet e dhëna janë publikuar në një platformë zyrtare që mirëmbahet nga Qeveria e Kosovës.²⁷ Sidoqoftë, për shkak të kufizimeve në kapacitete dhe për afateve të raportimit, ky informacion gjendet vetëm në një periudhë të caktuar të vitit ose kur nxirret raporti final, që është në mars të çdo viti.

23 Raporti Vjetor Financiar 2021, Ministria e Financave, Kosovë. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F25B154-2116-4D2D-96A4-25691600EA9D.pdf>

24 Raporti Vjetor Financiar 2021 për Financimin Publik të OSHC-ve <http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Raportiv-jetor2021.pdf>

25 Rregullorja MF - Nr - 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik në OJQ-të në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/en/220-2/>

26 Analizë e Legjislacionit të Kosovës lidhur me Filantropinë dhe OJQ-të, f. 12-13, në: https://figorg.com/wp-content/uploads/2020/05/ENG_Aanlize-legjislacionit-te-Kosoves-final-ENG-1-1.pdf

27 Platforma për Financimin Publik të OSHC-ve, në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/lista-e-hollesishme/>

Treguesi 1.7.e: Pjesa e OSHC-ve që tregon se dhënia e fondeve publike vendase është transparente, e drejtë dhe jo-diskriminuese.

2 – plotëson standardet minimalisht

22–25%

Bazuar tek Anketa, 9% e OSHC-ve thanë se ofrimi i financimit publik për OSHC-të ishte krejtësisht jo-transparent, ndërsa 38% u përgjigjën se ai ishte jo-mjaftueshëm transparent. Nga ana tjetër, 25% e konsiderojnë mjaftueshëm transparent dhe 15% shumë transparent.

Në mënyrë të ngjashme, pyetjes se si ishte ofrimi i financimit publik për OSHC-të, 47% u përgjigjën se nuk ishte aspak i drejtë ose jo-mjaftueshëm i drejtë. 22% të tjerë u përgjigjën se ishte i drejtë ose mjaftueshëm i drejtë.

Treguesi 1.7.f: Financimi publik nuk përjashton OSHC-të bazuar në përfaqësimin e grupit të synuar.

Sipas Anketës së OSHC-ve, vetëm 15% e të anketuarve thanë se autoritetet nuk deshën të financonin punën me njerëzit të cilëve ata ju shërbëjnë ose përfaqësojnë.

61% e OSHC-ve thanë se ata kanë aplikuar për fonde në 2021 dhe 36% thanë që nuk kanë. Më tej, 75% thanë se aplikimet e tyre ishin të suksesshme dhe 25% thanë që nuk ishin. Përqindja që u përgjigjën negativisht (25% që nuk kanë qenë të suksesshme në aplikim) u pyetën mbi arsyet e aplikimit të pasuksesshëm dhe 65% u përgjigjën se autoritetet financuan organizatat e tyre të preferuara, kurse 20% u përgjigjën se procedura e aplikimit ishte shumë e komplikuar.

Pyetjes se pse organizata nuk ka aplikuar për fonde publike, një numër i barabartë i të anketuarve u përgjigjën se ata ose nuk kanë nevojë për fonde publike ose nuk menduan se kishin shanse realiste të fitonin. Një 15% tjetër u përgjigj se fondet e ofruara nga financimet publike ishin shumë të vogla.

OS 1.8. Individët dhe biznesi gëzojnë lehtësira fiskale për donacionet e tyre për OSHC-të.

Treguesi 1.8.a: Legjislacioni mbi taksat lejon për lehtësira fiskale lidhur me:

- Donacionet individuale;
- Donacionet nga biznesi.

5 – plotëson të gjithë standardet

Individët mund të përfitojnë ulje të taksave për donacionet që bëjnë për OSHC-të. Bazuar në Ligjin No. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, Neni 28 specifikon se lejohet zbritja e taksave për aktivitetet e interesit publik. Kontributet e bëra nga taksapaguesit në formën e donacioneve për qëllime humanitare, shëndetësore, arsimore, fetare, shkencore, kulturore, të mbrojtjes së mjedisit dhe sportive, etj. konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në dhjetë përqind (10%) të të ardhurave të taksueshme përpara zbritjes të këtij kontributi. I njëjti kriter aplikohet për bizneset. Ata përfitojnë ulje taksash për donacionet e bëra për OSHC-të me aktivitete të interesit publik.

Treguesi 1.8.b Pjesa e individëve privat që kanë dhënë para tek një OSHC.

Sipas Charities Aid Foundation World Giving Index 2021²⁸, 59% ishte përqindja e individëve privat që dhuruan para për një OSHC në Kosovë. Kjo përqindje e bën Kosovën të pestën në botë për dhurimet private. Kombinuar me tregues të tjerë, në 2020 Kosova ishte midis dhjetë vendeve më bujare në botë.

28 CAF WORLD GIVING INDEX 2021. Charities Aid Foundation, <https://good2give.ngo/wp-content/uploads/2021/06/caf-ëorid-giving-index-2021.pdf> Shikuar me 8 Nëntor 2022.

OS 1.9. Ka lehtësira fiskale për OSHC-të.

Treguesi 1.9.a Masa në të cilën ligjet mbi taksat ofrojnë lehtësirat e duhura fiskale për OSHC-të.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

Legjislacioni aktual për detyrimet dhe përjashtimet lidhur me taksat për OJQ-të është Ligji No. 06/L-105 Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave²⁹, Ligji No. 05/L-028 Mbi Tatimin në të Ardhurat Personale³⁰ dhe Ligji No. 06/L-022 Për Ndërmarrjet Sociale³¹.

Sipas Ligjit Mbi Tatimin për të Ardhurat e Korporatave, të ardhurat e OSHC-ve nga grantet përjashtohen nga tatimi për të ardhurat e korporatave nëse OSHC-ja mban statusin e përfituesit publik dhe fondet janë përdorur për qëllimet e aktiviteteve të përfitimit publik³². Specifikisht, Neni 8 për të ardhurat e përjashtuara thekson se “përveç rasteve të parapara me nenin 34 të këtij ligji, të ardhurat e organizatave të regjistruara sipas legjislacionit për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave si organizata jo-qeveritare që kanë fituar dhe mbajtur statusin e përfituesit publik përjashtohen nga tatimi, me kusht që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime të përfitimit publik”.

OSHC-të me anëtarësi që gjenerojnë të ardhura nga kuotat nuk paguajnë tatim mbi kuotat, me kusht që të ardhurat të shfrytëzohen vetëm për qëllime të përfitimit publik ose për ofrimin e shërbimeve për anëtarët e tyre, me kusht që çmimi është më i ulët se ai i tregut. Sidoqoftë, Administrata e Taksave të Kosovës ka të drejtë të vendosë detyrime tatimore nëse verifikon se aktivitetet e OJQ-ve janë të natyrës tregëtare dhe jo të përfitimit publik. Kjo e drejtë hyn në fuqi kur ka raste teprice fitimi të OJQ-së që shpërndahet me qëllim për të rritur të ardhurat e stafit, si dhe për të rritur pagesa të tjera, apo mbifaturim për mallra dhe shërbime në krahasim me çmimet e tregut. Përveç kësaj, një taksë 10% aplikohet për fitimin në rastet e aktiviteteve ekonomike.

OSHC-të duhet të paguajnë tatimin mbi të ardhurat për të ardhurat që gjenerojnë nga aktivitetet ekonomike dhe aktivitetet e ndërmarrjeve sociale, dhe kjo rregullohet nga Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Neni 34. Ky Nen aplikohet edhe në rastet e tatimit mbi të ardhurat nga investimet e OSHC-ve. Fitimet kapitale ose nga investimet trajtohen si aktivitet ekonomik dhe taksohen sipas nenit 34 të ligjit të mësipërm.

Lidhur me detyrimet tatimore, nëse OSHC-të duhet të paguajnë taksa mbi donacionet, Neni 8 i Ligjit për Tatimin e të Ardhurave të Korporatave nuk bën dallim midis donacioneve individuale dhe të biznesit. Të dy tipet e donacioneve përjashtohen nga taksa nëse OSHC ka mbajtur statusin e përfituesit publik dhe të ardhurat përdoren ekskluzivisht për qëllimet e përfitimit publik.

Legjislacioni nuk ka dispozita specifike lidhur me pronat e paluejtshme, dhuratat apo trashëgiminë dhe raste të tilla do të kërkonin interpretim nga autoritetet lidhur me tatimin.

29 Ligji No. 06/L-105 Për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20988&langid=2>. Shikuar me 8 Nëntor 2022.

30 Ligji No. 05/L-028 Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014> Shikuar me 8 Nëntor 2022.

31 Ligji No. 06/L-022 Mbi Ndërmarrjet Sociale <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18187> Shikuar me 8 Nëntor 2022.

32 Ka rreth 200 OSHC me Statusin e Përfituesit Publik në Kosovë. Burimi: Regjistri Publik i OSHC-ve në Kosovë <https://ojq.rks-gov.net/KerkoO-JQ.aspx>

OS 1.10. Politikat dhe mjedisi ligjor ofrojnë insentiva dhe lehtësojnë vullnetarizmin dhe punësimin në OSHC.

Treguesi 1.10.a: Janë adoptuar ligje që rregullojnë vullnetarizmin.

1 – nuk i plotëson standardet

Kosova nuk ka një ligj për vullnetarizmin. Ligji i vetëm që përmend vullnetarizmin është Ligji No. 03/L-145 Për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë³³. Sidoqoftë, ai ju referohet vullnetarëve 15–24 vjeç dhe kufizimi në moshë paraqet një pengesë serioze për punën vullnetare dhe përfshirjen e barabartë.

Treguesi 1.10.b: Strategjitë dhe programet e qeverisë për vullnetarizmin mbështesin vullnetarizmin tek OSHC-të dhe janë dhënë burime të mjaftueshme për zbatimin.

2 – plotëson standardet minimalisht

Strategjia e Rinisë 2019–2023 dhe Plani saj i Veprimit³⁴ është një strategji e plotë, për të rinjtë në Kosovë, e miratuar nga Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Nën Objektivin 4 për Zhvillimin e Vullnetarizmit, Strategjia thekson mbështetjen çdo vit të 20 organizatave rinore që promovojnë vullnetarizmin dhe punën vullnetare. Aktivitetet specifike përfshijnë zhvillimin e legjislacionit për vullnetarizmin si dhe zhvillimin e kapaciteteve të OSHC-ve që të rekrutojnë, angazhojnë dhe menaxhojnë vullnetarët.

Megjithë këto përpjekje, aktivitetet vullnetare në Kosovë ngelen të parregulluara dhe të pakordinuara dhe ka një mungesë të burimeve për zbatimin e tyre.

Treguesi 1.10.c: Pjesa e OSHC-ve që përfitojnë nga strategjitë dhe programet shtetërore të punësimit.

Lidhur me përfitimet nga programet e punësimit të Qeverisë, 15.9% e OSHC-ve u përgjigjën se kanë përfituar. Shembujt përfshijnë praktikat tre-mujore dhe kompensimi me 70% i shpenzimeve të tyre nga Zyra e Punësimit. Ndërsa 13.6% e OSHC-ve u përgjigjën se në 2021 organizata e tyre ka përfituar nga mbështetja e qeverisë për punësimin gjatë COVID.

Treguesi 1.10.d: Pjesa e OSHC-ve që përfitojnë nga strategjitë dhe programet shtetërore të vullnetarizmit.

Lidhur me përfitimet nga programet e qeverisë për vullnetarizmin, vetëm 4.5% e OSHC-ve u përgjigjën se ata kanë përfituar, ndërsa 93.2% u përgjigjën se nuk kanë përfituar. Kjo tregon se ky burim nuk është shfrytëzuar / përdorur siç duhet (kur ka ekzistuar).

Treguesi 1.10.e: Pjesa e punonjësve të OSHC-ve në numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

Sipas Raportit Vjetor 2021 të Fondit të Kursimeve të Pensionit në Kosovë³⁵, një total prej 25,385 punonjësish qenë të angazhuar formalisht në OJQ-të gjatë këtij viti. Ky numër përfaqëson 4.9% të punonjësve të angazhuar në të paktën një sektor gjatë 2021.

Treguesi 1.10.f: Përqindja e njerëzve që kanë qenë vullnetarë në një organizatë.

Sipas Charities Aid Foundation World Giving Index 2021³⁶, 10% e njerëzve kanë dhuruar kohën e tyre në kuadrin e një organizate në Kosovë, në 2021.

33 Ligji No. 03/L-145 Për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2654> Shikuar me 8 Nëntor 2022.

34 Strategjia e Rinisë 2019–2023 https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategy_for_Youth_2019-2023.pdf Shikuar me 8 Nëntor 2022.

35 Raporti Vjetor 2021 i Fondit të Kursimeve të Pensionit në Kosovë, në: http://www.trusti.org/ep-content/uploads/2021/12/AnnualReport2021_eng_web.pdf Shikuar me 8 Nëntor 2022.

36 CAF WORLD GIVING INDEX 2021. Charities Aid Foundation, <https://good2give.ngo/ep-content/uploads/2021/06/caf-world-giving-index-2021.pdf> Shikuar me 8 Nëntor 2022.



Objektivi Specifik 2

Bashkëpunim dhe partneritet i fuqizuar midis OSHC-ve dhe institucioneve publike.

OS 2.1. Autoritetet dhe institucionet publike përfshijnë OSHC-të në proceset vendim-marrëse dhe politikë-bërëse.

Treguesi 2.1.a: Ligjet, aktet nën-ligjore, strategjitë dhe aktet e tjera të interesit publik dhe reformat e politikave janë konsultuar efektivisht me OSHC-të në:

- OSHC-të kanë akses në draft-dokumentet që nga fillimi i procesit të përgatitjes deri në fund të procedurës së adoptimit;
- Të paktën 15 ditë janë lënë për komentim përpara se draft-dokumenti të kalojë në procedurat e adoptimit;
- Përdorimi i procedurave të jashtëzakonshme/përsheptuara për adoptimin e legjislacionit pa mundësinë e konsultimit është një përjashtim dhe i justifikuar sic duhet;
- Raportet mbi rezultatet e konsultimeve publike, përfshirë arsyet për mos-marrjen parasysh të komenteve, janë publikuar në kohë;
- Anëtarët e grupeve të punës nga OSHC-të janë përzgjedhur bazuar në një thirrje publike, kriteret të qarta dhe barazinë;
- Anëtarët e grupeve të punës nga OSHC-të përfshijnë përfaqësues të shoqërisë si e tërë, përfshirë grupet e grave, LGBTQIA, migrantëve, minoriteteve, pa-aftësisë dhe të tjerë, në përputhje me Qasjen e Bazuar në të Drejtat e Njeriut.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

Në Kosovë, Rregullorja (QRK) No. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik³⁷, specifikon kohën minimale për publikun për të dhënë komentet e tyre për konsultimet online, që është 15 ditë. Përveç kësaj, ajo vendos rregullat për organizimin e takimeve, kërkesat lidhur me raportimin, dhe rregullon se si duhet bërë raportimi mbi rezultatet e konsultimit publik. Për të lehtësuar procesin e konsultimeve publike, për të mundësuar një lehtësim më të mirë të procesit për mbledhjen e komenteve të publikut dhe OSHC-ve dhe në këtë mënyrë, për të zhvilluar konsultimet publike, qeveria e Kosovës ka ngritur Platformën e Konsultimeve Publike në Kosovë³⁸. Megjithë ndërhyrjet e bëra për të siguruar plotësinë e këtij procesi, niveli i përgjigjeve nga shoqëria civile dhe qytetarët mbetet relativisht i ulët kundrejt konsultimeve publike nëpërmjet portalit online të konsultimeve. Arsyet e përmendura lidhen kryesisht me mungesën e reagimit dhe aftësinë e diskutueshme të institucioneve për tu angazhuar në një qasje pjesëmarrëse me OSHC-të dhe publikun. Përsa i përket raportimit, çdo vit publikohet Raporti Vjetor mbi Konsultimin. Sidoqoftë, nuk jepen detaje lidhur me arsyet për refuzimin e komenteve të bëra nga OJT-të. Institucionet krijojnë grupe të ndryshme pune konsultative për të plotësuar detyrimet ligjore të procesit të konsultimit; sidoqoftë, formimi i grupeve të punës dhe puna e tyre nuk është dokumentuar në formë të organizuar.

37 Rregullore (GRK) No. 05/2016 Për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15036>

38 Platforma e Konsultimeve Publike në Kosovë, në: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-62bab617062c9.pdf>

Treguesi 2.1.b: OSHC-të janë përfshirë efektivisht në mekanizmat mbikqyrës.

Në Kosovë, sistemi i zbatimit të ligjit mbetet problematik krahasuar me kuadrin ligjor, i cili është në përputhje me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare. Lidhur me mekanizmat mbikqyrës, këto zakonisht bëhen nëpërmjet vlerësimeve nga OSHC-të të legjislacionit në fushën e tyre. Ka organizata të shoqërisë civile në Kosovë që mbikqyrin zbatimin e ligjeve dhe punojnë për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe aplikimin e drejtë të ligjeve. Këto organizata mund t'ju ofrojnë ndihmë dhe mbështetje qytetarëve të Kosovës kur ata ndjejnë se ligjet nuk po aplikohen drejt në rastin e tyre dhe mund të ndihmojnë për zgjidhjen e çështjeve përsa i përket përputhshmërisë me ligjet në fuqi. Ato fokusohen në vlerësimet pas. Sidoqoftë, këto organizata kryesisht bëjnë monitorim sektorial të zbatimit të ligjeve. Prandaj, mund të konkludohet që OSHC-të nuk janë të përfshira efektivisht në mekanizmat mbikqyrës dhe që të gjitha aktivitetet bëhen zakonisht nga OSHC-të në kuadrin e projekteve. Megjithatë ka raste kur institucionet bashkëpunojnë me OSHC-të në inisiativa të tilla, rrallë inisiativa për të mbikqyrur vjen nga institucionet.

Treguesi 2.1.c: Pjesa e OSHC-ve që kanë marrë pjesë në konsultime gjatë përgatitjes së raporteve shtetërore në kuadrin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe detyrimeve tjera si dhe në zbatimin e rekomandimeve të tyre.

Pyetjes nëse autoritetet qeveritare nxjerrin thirrje për pjesëmarrjen e OSHC-ve në konsultime për draftimin e raporteve qeveritare në kuadrin e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ose konventave të tjera, ose zbatimin e konventave, 34% e OSHC-ve u përgjigjën "po", ndërsa 43% u përgjigjën "nuk e di". Nga numri total i përgjigjeve pozitive, 80% u përgjigjën se kanë marrë pjesë në thirrjet e hapura të qeverisë për pjesëmarrjen e OSHC-ve. Të njejtës pyetje, 20% ju përgjigjën që nuk kanë marrë pjesë.

OS 2.2. Autoritetet dhe institucionet publike pranojnë rëndësinë e shoqërisë civile në debatin shoqëror mbi politikat dhe proceset e integritimit në BE.

Treguesi 2.2.a: Masa në të cilën OSHC-të vlerësojnë si mbështetës qëndrimin e zyrtarëve publik kundrejt shoqërisë civile.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar 56%

Pyetjes se sa mbështetës kanë qenë zyrtarët publik kundrejt shoqërisë civile, më shumë se gjysma e të anketuarve nga OSHC-të u përgjigjën negativisht, 'aspak mbështetës' ose 'jo-mjaftueshëm mbështetës'. Pothuaj një e treta e konsiderojnë qeverinë si mjaftueshëm mbështetëse. Pjesa më sfiduese për tu parë në këto përgjigje ishte se 0% e shohin qeverinë si 'shumë mbështetëse'.

Njëkohësisht, kjo pikëpamje bie ndesh me përgjigjet e autoriteteve publike, që e konsiderojnë veten si 'shumë mbështetëse' ose 'mjaftueshëm mbështetëse' kundrejt organizatave të shoqërisë civile.

OS 2.3. Autoritetet publike kontribuojnë në fuqizimin e shoqërisë civile duke bashkëpunuar me shoqërinë civile nëpërmjet kuadrit strategjik të politikave dhe mekanizmave të duhur institucional.

Treguesi 2.3.a: Pjesa e OSHC-ve që janë konsultuar efektivisht gjatë përgatitjes së strategjive të bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Pyetjes nëse në 2021 kishte një strategji për të punuar me shoqërinë civile, pothuaj një e treta, ose 29% e të anketuarve, thanë se kishte. Të tjerët u përgjigjën negativisht - 25% - dhe 'nuk e di' - 45%. Ky rezultat është shqetësues sepse Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile³⁹ ka qënë

39 Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019-2023 <https://zgm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Strategjia%20ne%20tri%20qjuhe.pdf> Shikuar me 17 Nëntor 2022.

një dokument detyruar prej vitesh në Kosovë dhe shpesh referohet si baza e procesit të bashkëpunimit OSHC–Qeveri. Ka grupe pune të bazuara në strategji që konsistojnë në anëtarë nga OSHC-të, por thirrjet për zëvendësimin e anëtarëve janë shumë të shpeshta.

Pyetjes nëse strategjia ishte zhvilluar nëpërmjet konsultimit publik, një pjesë e mirë e OSHC-ve ose 77% u përgjigjën se janë dakort me këtë. Pjesa tjetër thanë që nuk e dinin. Strategjia kaloi nëpër një proces konsultimi publik dhe ka një raport të plotë për të në Platformën e Konsultimeve Publike.

Pyetjes nëse OSHC-të ishin konsultuar efektivisht gjatë zhvillimit të strategjisë, shumica e OSHC-ve - 80% - u përgjigjën se ishin konsultuar mjaftueshëm efektivisht; megjithatë vetëm 10% u përgjigjën që ata ishin konsultuar plotësisht efektivisht. Pjesa tjetër thanë që nuk e dinë.

Treguesi 2.3.b: Përfituesit e IPA kanë adoptuar strategji të vlefshme të bashkëpunimit me shoqërinë civile.

5 – plotëson të gjithë standardet

Në Kosovë, Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile⁴⁰ fillimisht është zhvilluar dhe adoptuar në 2013. Kjo ishte hera e parë që qeveria njohu formalisht shoqërinë civile si aktor kryesor në politikë-bërje dhe qeverisjen e mirë. Me përfundimin e versionit të parë, një strategji e re u adoptua, e cila është akoma e vlefshme dhe mbulon periudhën 2019–2023.

Në strategjinë e dytë, qeveria e Kosovës tregoi angazhimin e saj për të investuar burime shtesë financiare dhe njerëzore për krijimin e mekanizmeve funksionale për një bashkëpunim të strukturuar midis qeverisë dhe OSHC-ve. Për këtë arsye, katër objektiva strategjike janë vendosur për periudhën e zbatimit: 1. Pjesëmarrje e rritur e shoqërisë civile në politikë-bërje; 2. Llogaridhënie dhe transparencë e rritur lidhur me financimin për OSHC-të; 3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike; dhe 4. Vullnetarizëm i rritur në programet e përfitimit publik. Strategjia ka mundur një dialog më të strukturuar midis qeverisë dhe shoqërisë civile.

Treguesi 2.3.c: Strategjitë e bashkëpunimit me shoqërinë civile shoqërohen me plane veprime të buxhetuara.

5 – plotëson të gjithë standardet

Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile shoqërohet me Planin e Veprimit. Plani i Veprimit ka një buxhet specifik⁴¹, që është përcaktuar për secilin nga katër objektivat specifike. Sidoqoftë, nuk mund të thuhet nëse ka një shpërndarje të buxhetit të planifikuar. Për më tepër, disa tema që ndjekin inisiativa të donatorëve, si vullnetarizmi e të tjera, mbështeten nga donatorët ndërkombëtar. Metodologjia për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e Strategjisë ka arritur të përcaktojë tregues më të saktë për secilin objektivë strategjik dhe pika reference për çdo vit të Planit të Veprimit, që janë reflektuar në nevojat për buxhet.

Treguesi 2.3.d: Pjesa e OSHC-ve që vlerësojnë strategjitë e bashkëpunimit me shoqërinë civile si të përshtatshme dhe efektive.

Në kuadër të Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile dhe rëndësisë së saj përsa i përket adresimit të nevojave, politikave dhe prioritetëve të shoqërisë civile nga objektivat e strategjisë, shumica e të anketuarve nga OSHC-të u përgjigjën se ishte “mjaftueshëm e rëndësishme”.

Njëkohësisht, shumica e përfaqësuesve të autoriteteve publike u përgjigjën ‘shumë e rëndësishme’.

40 Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023 <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Strategjia%20ne%20tri%20gjuhe.pdf> Shikuar me 17 Nëntor 2022.

41 Burimi: Zyra e Qeverisjes së Mirë, Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

Më tej, të anketuarit nga autoritetet publike thanë se objektivat e Strategjisë 2019–2023 ishin përcaktuar bazuar në konsultimet me shoqërinë civile, duke marrë në konsideratë rezultatet e vlerësimit të strategjisë së mëparshme, si dhe prioritetet më të gjera të përfshira në dokumentet përkatëse të Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë, është siguruar komplementariteti dhe koherenca me objektivat dhe masat e planifikuara në dokumentet e tjera strategjike të qeverisë, si Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për 2017–2021, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016–2021, Strategjia për Rregullim më të Mirë 2017–2021 dhe Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë 2017–2021.

Në kontekst të Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile dhe efektivitetit të saj lidhur me arritjen e objektivave dhe rezultateve, përfshirë rezultatet e ndryshme për grupe të ndryshme, më shumë se gjysma e OSHC-ve u përgjigjën se ishte 'mjaftueshëm efektive'. Gjithashtu, në Anketën e autoriteteve publike, shumica u përgjigjën 'mjaftueshëm efektive'.

Treguesi 2.3.e: Strukturave publike, përgjegjëse për zbatimin e strategjive të bashkëpunimit me shoqërinë civile, ju janë dhënë burimet e duhura.

Në 2 prill 2019, me Vendimin No. 05/96, Qeveria krijoi mekanizmin për bashkëpunimin e qeverisë me shoqërinë civile, konkretisht Këshillin e Bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë Civile. Këshilli i Bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë Civile përbëhet nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe qeverisë, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019–2023. Detyrat e Këshillit janë bazuar në rregulloren e punës së Këshillit. Që nga krijimi i tij në 2019, Këshilli është ndarë në 4 grupe pune sipas fushave të identifikuara në strategji. Këto janë: Objektivi 1. Pjesëmarrje e rritur e shoqërisë civile në politikë-bërje; Objektivi 2. Llogaridhënie dhe transparencë e rritur lidhur me financimin për OSHC-të; Objektivi 3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike; dhe Objektivi 4. Vullnetarizëm i rritur në programet e përfitimit publik. Megjithatë progresin e arritur në zbatimin e Strategjisë, Këshilli duhej të bënte përpjekje për angazhimin e anëtarëve në një mënyrë kuptim-plotë. Angazhimi varion nga pjesëmarrja në takime tek kontributi i anëtarëve si pjesë e grupit të punës së strategjisë. Sekretariati i Këshillit nuk ka stafin e mjaftueshëm. Vetëm dy persona janë caktuar që të merren me të gjithë procedurat dhe monitorimin.

Treguesi 2.3.f: Mekanizmat për dialog midis këshillave të bashkëpunimit të shoqërisë civile dhe qeverisë qëndrore përfshijnë OSHC-të në mënyrë kuptim plotë në:

- Ata kanë një program pune të dakortësuar;
- Ata kanë rënë dakort për rregullat dhe procedurat;
- Ata takohen rregullisht;
- Rregullat lejojnë OSHC-të të organizojnë takime dhe kontribuojnë në zhvillimin e axhendës;
- Ka një ndjekje të duhur të konkluzioneve dhe rekomandimeve.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

Sipas Vendimit të Qeverisë no. 05/96 datë 2 Prill 2019, Këshilli për Bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile është grupi formal që koordinon procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile. Janë 29 anëtarë, 15 nga OSHC-të dhe 14 nga qeveria⁴². Anëtarët nga OSHC-të zgjidhen nga vetë organizatat e shoqërisë civile, megjithatë njëri është caktuar nga Platforma CiviKos, një rrjet i gjërë i OSHC-ve në Kosovë. Mandati i anëtarëve të Këshillit është katër (4) vite, me të drejtë rizgjedhje. Këshilli operon bazuar në Rregullat e Procedurave të cilat janë zhvilluar dhe adoptuar nga anëtarët e Këshillit bazuar në Vendimin e Qeverisë no. 05/96 datë 2 Prill 2019 për krijimin e Këshillit, firmosur nga Kryeministri. Përsa i përket programit të tij, Këshilli e bazon punën e tij në Planin e Veprimit të Strategjisë për Bashkëpun-

⁴² Këshilli për Bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile në: <https://kryeministri.rks-gov.net/zyra-e-kryeministrit/keshilli-per-bashkepunim-te-qeverise-me-shoqerine-civile/>

imin me Shoqërinë Civile. Për shkak të pandemisë dhe shkaqeve të tjera administrative, në 2021 Këshilli u mbledh vetëm një herë. Axhenda e takimit është përgatitur nga Sekretariati dhe anëtarët mund të propozojnë pika diskutimi. Sekretariati ka thirrur takime të Këshillit pas konsultimit me Bashkë-Kryetarët lidhur me datën, axhendën, materialet e diskutimit dhe çdo çështje tjetër me rëndësi për përgatitjen e takimit. Me adoptimin e rekomandimeve, Këshilli është përgjegjës për zbatimin e tyre. Këshilli bashkëpunon me institucionet e tjera publike, si dhe organizatat e shoqërisë civile për realizimin e këtyre detyrave. Sidoqoftë, ka pasur sfida lidhur me organizimin e duhur të takimeve, vendosjen e axhendës dhe ndjekjen e punës së Këshillit.



Objektivi Specifik 3

Është përforcuar kapaciteti dhe aftësia e OSHC-ve për të realizuar aktivitetet me efektivitet.

OS 3.1. Strukturat e qeverisjes së brendshme të OSHC-ve bazohen në parimet e qeverisjes së mirë.

Treguesi 3.1.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë një organ qeverisës të pavarur dhe efektiv, me terma të qarta reference, për mbikqyrjen e qëllimeve strategjike, ndikimit, menaxhimit, përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe llogaridhënies së organizatës.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar 57%

Pjesa e OSHC-ve që kanë një organ dhe dokument qeverisës, ku dokumenti qeverisës përcakton rolet dhe përgjegjësitë dhe nuk kanë në bord anëtarë stafi të paguar ishte 57%. Në Anketën e OSHC-ve, 96% e OSHC-ve raportuan se kanë një organ qeverisës dhe 99% se kanë një dokument qeverisës. Në 94% të OSHC-ve, dokumenti qeverisës përcakton rolet dhe përgjegjësitë e organeve qeverisëse. Sidoqoftë, është shqetësuese që 32% e të anketuarve raportuan se drejtori ekzekutiv ose ndonjë anëtar tjetër i paguar i stafit të organizatës së tyre ishte anëtar i organit qeverisës.

Treguesi 3.1.b: Pjesa e OSHC-ve që në mënyrë të rregullt shqyrtojnë konfliktin e interesit lidhur me marrëdhëniet politike, ekonomike dhe personale të organit të tyre qeverisës.

2 – plotëson standardet minimalisht 25%

Bazuar në Anketë, 25% e OSHC-ve kërkojnë që të nënshkruhet çdo vit deklarata e konfliktit të intereseve. Nga ana tjetër, 14% nuk kanë kërkuar kurrë nënshkrimin e një deklarate të konfliktit të interesit nga anëtarët e organit qeverisës, ndërsa 49% e kanë kërkuar vetëm një herë, me rastin e anëtarësimit.

Treguesi 3.1.c: Pjesa e OSHC-ve që ndajnë informacionin e duhur mbi organizatën nëpërmjet mjeteve dhe kanaleve që janë të aksesueshme nga të gjithë palët e interesuara përsa i përket publikimit të:

- statuteve;
- strukturës qeverisëse;
- politikave organizative.

2 – plotëson standardet minimalisht 29%

Bazuar në anketën e OSHC-ve, 29% e të anketuarve thanë se ata publikojnë dokumentet qeverisëse në faqen e internetit, përfshirë strukturën organizative, anëtarët, ose të dyja, dhe gjithashtu publikojnë politikat organizative të listuara në Anketë.

Lidhur me nëse dokumentet qeverisëse të organizatës, statuti, akti i themelimit, ose dokumente të ngjashëm themelues janë botuar në faqen e internetit të organizatës, 31% thanë që janë publikuar. Kësaj pyetje, 30% u përgjigjën 'jo'. Sidoqoftë gjetja më sfiduese ishte se 27% e organizatave nuk kishin një faqe interneti.

Pyetjes nëse publikohen në faqen e internetit të organizatës struktura bordit të organizatës dhe emrat e anëtarëve të bordit, vetëm 21% u përgjigjën se e bëjnë për të dyja, me strukturën organizative si më kryesoren. Gjetje sfiduese ishte se 23% u përgjigjën se nuk publikojnë asnjërën prej këtyre dokumenteve. Për më tepër, 67% u përgjigjën se nuk kanë publikuar në faqet e tyre të internetit politika organizative si Politika e Rekrutimit, Politika mbi Diversitetin, Barazinë dhe Përfshirjen, Politika e Barazisë Gjinore, etj.

Treguesi 3.1.d: Pjesa e OSHC-ve që kanë një politikë organizative të barazisë gjinore.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	50%
---	-----

Lidhur me politikën organizative të barazisë gjinore, 50% u përgjigjën se e kanë këtë politikë efektive.

Treguesi 3.1.e: Pjesa e OSHC-ve që kanë strategji organizative, përfshirë vizion, mision dhe qëllime.

4 – plotëson shumicën e standardeve	69%
-------------------------------------	-----

Sipas Anketës, 69% e të anketuarve thanë se organizata e tyre ka një strategji e cila artikulon të paktën njërin nga tre elementët, vizionin, misionin, ose qëllimet.

Pyetjes nëse organizata ka një strategji organizative, një plan strategjik ose strategji të ngjashme, 75% e të anketuarve thanë se kanë. Specifikisht, për vitin 2021, rreth 58% e të anketuarve thanë se strategjitë e tyre organizative përmbajnë vizionin, misionin dhe qëllimet organizative.

OS 3.2. OSHC-të janë të afta të komunikojnë rezultatet e aktiviteteve të tyre tek publiku.

Treguesi 3.2.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë të paktën një kanal on-line komunikimi.

5 – plotëson të gjithë standardet	95%
-----------------------------------	-----

Anketa e OSHC-ve nxori në pah se vetëm 5% e të anketuarve nuk përdorin kanalet online të komunikimit të cilat përdoren nga organizatat për të komunikuar mbi punën e tyre me publikun. 56% e të anketuarve thanë se kanë përdorur faqen e internetit për të komunikuar. Facebook është kanali më popullor, me 92% që e përdornin, ndjekur nga Instagram, me 53%. Media tradicionale si TV, gazetat dhe radio, janë përdorur nga vetëm 3.1% e të anketuarve.

Treguesi 3.2.b: Pjesa e OSHC-ve që kanë staf komunikimi të specializuar.

Pyetjes nëse OSHC-të kanë caktuar një staf përgjegjës për komunikimin e jashtëm me palët e interesuara dhe me publikun, 70% u përgjigjën se kanë staf, ndërsa 30% u përgjigjën se nuk kanë.

Treguesi 3.2.c: Pjesa e OSHC-ve që bashkëpunojnë me median.

Lidhur me partneritetin me median, 34% e OSHC-ve theksuan se në 2021 ata janë angazhuar në partneritete dhe kanë bashkëpunuar me sektorin e medias.

OS 3.3. OSHC-të janë transparente rreth aktiviteteve programatike dhe burimet e financimit.

Treguesi 3.3.a: Pjesa e OSHC-ve që publikojnë raportet e tyre vjetore dhe bilanci financiar.

2 – plotëson standardet minimalisht	38%
-------------------------------------	-----

Të dyja, raporti vjetor dhe bilanci financiar janë publikuar nga 38% e OSHC-ve në 2021. 59% e OSHC-ve publikuan raportet vjetore, ndërsa 45% publikuan bilanci financiar dhe 28% nuk publikuan asnjë lloj raporti.

Lidhur me të dhënat e publikuara, faqet e internetit janë përdorur nga 33% dhe kopjet e printuara nga 27%, ndërsa mjetet alternative përbëjnë 18%, me median sociale dhe dërgimin në listat e adresave për anëtarët dhe donatorët.

Treguesi 3.3.b: Pjesa e OSHC-ve që publikojnë informacionin mbi burimet e financimit dhe shumat e marra në vitin paraardhës.

2 – plotëson standardet minimalisht	23%
-------------------------------------	-----

Pyetjes nëse organizata ka publikuar informacion mbi burimet e financimit dhe shumat përkatëse të marra, 23% thanë se nuk i kanë publikuar. Nga ana tjetër, 27% publikuan detaje mbi burimet e financimit dhe shumat e marra. Kjo shifër ndahet në 65% për burimet e financimit dhe 29% për shumat e marra. Sikurse lidhur me mos-publikimin e raporteve vjetore, përgjigjet janë të ndryshme, por shumica theksuan fondet e pamjaftueshme si arsyen kryesore për mos-publikimin. Të tjerët theksuan se raportet e tyre vjetore janë dorëzuar rregullisht tek Administrata e Taksava dhe Zyra për Regjistrimin e OJQ-ve, si pjesë e kërkesave rrugullatore dhe ligjore.

Treguesi 3.3.c: Shkalla e besimit publik në OSHC-të.

Nuk ka të dhëna për 2021.

OS 3.4. OSHC-të monitorojnë dhe vlerësojnë rezultatet dhe ndikimin e punës së tyre.

Treguesi 3.4.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë bërë një vlerësim të punës së tyre vitin e kaluar.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar	55%
---	-----

Pyetjes nëse në 2021 organizata ka bërë vlerësim të brendshëm apo të jashtëm të një projekti, strategjie, procesi të brendshëm, ose diçkaje tjetër, 55% u përgjigjën se kanë bërë për projektet e tyre, 35% u përgjigjën se e kanë bërë për strategjitë dhe 40% për proceset e brendshme. Rreth 15% u përgjigjën se nuk kanë bërë ndonjë lloj vlerësimi.

Lidhur me numrin e vlerësimeve të bëra në 2021, shumica e përgjigjeve ishte 2-4, me 55% e të anketuarve. Për OSHC-të që nuk kanë bërë ndonjë vlerësim, arsyet ishin se nuk kishin projekte ose se nuk kishte kapacitetet e nevojshme për realizimin e vlerësimit.

OS 3.5. OSHC-të përdorin kërkimin dhe evidencën për të mbështetur punën e tyre.

Treguesi 3.5.a: Pjesa e OSHC-ve puna e të cilave është bazuar në evidencën e gjeneruar nëpërmjet kërkimit.

5 – plotëson të gjithë standardet

95%

Në Anketën e OSHC-ve, 95% e OSHC-ve u përgjigjën se ata përdorin një lloj kërkimi për tu informuar rreth punës së tyre. Pyetjes se çfarë lloj kërkimi kanë bërë për tu informuar rreth punës së tyre, 56% u përgjigjën se kërkimi në terren ishte metoda e preferuar. 53% u përgjigjën se janë përdorur konsultimet me komunitetin. Edhe anketat janë përdorur nga 43% e OSHC-ve, por pak u përgjigjën se kanë përdorur anketat e përgjithshme të opinionit, me vetëm 19% që i kanë përdorur ato. Pyetjes lidhur me arsyet për mungesën e kërkimit, komentet ishin humbja e motivimit tek vullnetarët që bëjnë kërkim. Me fjalë të tjera, organizatat nuk kishin kapacitetet për këtë pjesë të punës së tyre. Duke konsideruar se vetëm 5% u përgjigjën se nuk kanë bërë ndonjë kërkim për tu informuar rreth punës së tyre, mund të konkludohet se ky standard është realizuar plotësisht.

Treguesi 3.5.b: Pjesa e OSHC-ve puna e të cilave mbështetet në konsultimin me njerëzit që kanë një interes në punën e tyre të tanishme ose të ardhshme.

4 – plotëson shumicën e standardeve

63%

Lidhur me konsultimet me aktorët e interesuar, 63% u përgjigjën se janë konsultuar me komunitetet dhe partnerët lokal. Si anëtarët ashtu edhe autoritetet lokale janë konsultuar njësoj, nga më shumë se gjysma e organizatave pjesëmarrëse. Përsa i përket aktorëve më pak të konsultuar, numri më i vogël ishin donatorët individual me 15%. Në rastin e mungesës së konsultimit, që përbënin 3%, problemi është lidhur me mungesën e interesit nga ana e palëve të interesuara.

OS 3.6. OSHC-të punojnë në partneritete të drejta dhe të respektueshme për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Treguesi 3.6.a: Pjesa e OSHC-ve që marrin pjesë në rrjetet lokale, qëndrore dhe ndërkombëtare.

Lidhur me anëtarësinë e OSHQ-ve në rrjetet të ndryshme të shoqërisë civile, rrjetet kombëtare ishin dominuese, me 65% të anketuarve. Rrjetet formale u shënuan nga 55% dhe rrjetet ndërkombëtare nga 48%. Rrjetet informale ishin më pak popullore, dhe 5% e të anketuarve thanë se nuk janë pjesë e ndonjë rrjeti. Në total, 91% e OSHC-ve ishin anëtarë të njërit prej rrjeteve qoftë rrjet lokal, kombëtar, ose ndërkombëtar.

Treguesi 3.6.b: Pjesa e OSHC-ve të angazhuara në partneritete ndër-sektoriale me akademinë, partnerët social dhe sektorin privat.

Pyetjes nëse organizata ka patur partneritete me sektorin privat dhe median, pothuaj 35% pohuan se janë angazhuar si partnerë me ta. Është interesante që institucionet publike ishin me vlerë shumë të ulët, me vetëm 1.7% si partnerë të OSHQ-ve.

OS 3.7. OSHC-të kanë një financim të diversifikuar.

Treguesi 3.7.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë donatorë të ndryshëm.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar 53%

53% e OSHC-ve u përgjigjën se kanë marrë më shumë se 50% të buxhetit të tyre nga një donator i vetëm ose nga një financim i diversifikuar.

Lidhur me pyetjen nëse kanë patur financimin e diversifikuar nga donatorët, dmth nga dy ose më shumë donatorë, 47% e OSHC-ve u përgjigjën se kanë patur. Specifikisht, 42% u përgjigjën se kanë më shumë se një donator, ndërsa 20% e OSHC-ve u përgjigjën se kanë dy ose më shumë donatorë. Njëkohësisht, 38% u përgjigjën se nuk kanë ndonjë donator tjetër.

Lidhur me burimet e financimit, në krye ishin burimet qeveritare lokale ose qendrore me 49%, ndjekur me 47% nga fondacionet e huaja private dhe organizatat ndërkombëtare. Nga ana tjetër, donatorët bilateralë dhe Komisioni Evropian, por edhe Kombet e Bashkuara, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Këshilli i Evropës ishin rreth 30%. Përqindja më e ulët e përgjigjeve – 18% - ishte përsa i përket fondacioneve private vendase.

Pyetjes se sa kanë marrë më shumë se 50% të buxhetit nga një donator i vetëm, 47% u përgjigjën se kanë marrë. Njëkohësisht, 61% u përgjigjën se nuk kanë donatorë për më shumë se gjysmën e buxhetit të tyre.

Treguesi 3.7.b: Pjesa e OSHC-ve që sigurojnë fonde nga burime të tjera përveç donatorëve, për shembull kuotat e anëtarësisë, donacionet individuale/nga biznesi dhe aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave.

4 – plotëson shumicën e standardeve 63%

Pyetjes se sa OSHC kanë të paktën një burim tjetër të ardhurash, 63% u përgjigjën që kanë. Lidhur me burimet e financimit ndryshe nga donatorët, për donacionet individuale, 33% u përgjigjën pozitivisht dhe 46% negativisht. Kjo ndiqet nga aktiviteti ekonomik /aktiviteti i ndërmarrjeve sociale / ofrimi i shërbimeve i OSHC-ve, me 25% përgjigje pozitive dhe 50% negative. Kuotat e anëtarësisë kishin 21% përgjigje pozitive dhe 54% negative. Lidhur me bizneset private, vetëm 8% e përgjigjeve ishin pozitive, ndërsa 56% negative. Kjo ishte një përqindje e lartë negative, duke pasur parasysh potencialin e këtyre burimeve dhe rëndësinë e përgjegjësinë sociale korporative. Lidhur me 'crowdfunding', 13% u përgjigjën pozitivisht dhe 56% negativisht, gjithashtu duke e theksuar si një fushë që mund të eksplorohet më shumë në të ardhmen.

OS 3.8. OSHC-të kanë burime njerëzore efektive, të fuqizuara dhe të zhvilluara.

Treguesi 3.8.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë staf të punësuar.

Në 2021, 25% e OSHC-ve punuan pa pasur ndonjë staf të paguar. Nga numri total i përgjigjeve, 35% kanë punësuar 1–5 persona, 13%, 6–10 persona, dhe 25% 11 ose më shumë persona.

Treguesi 3.8.b: Pjesa e OSHC-ve që kanë politika organizative të burimeve njerëzore.

1 – nuk i plotëson standardet 2%

Vetëm 2% e OSHC-ve pjesëmarrëse në Anketë kanë të nëntë politikat organizative të burimeve njerëzore. Pyetjes nëse kanë ndonjë nga politikat organizative që zbatohen në organizatë, 10.4% u përgjigjën se nuk

kanë. Nga ana tjetër, 27% u përgjigjën se kanë një politikë, 4% dy, 10% tre, 6% katër, 6% gjashtë, 8% shtatë, dhe 2% tetë ose nëntë.

Nga politikat organizative të burimeve njerëzore të përmendura në Anketë, 42% thanë se kanë Politike Rekrutimi, 33% Politikë të Diversitetit, Barazisë dhe Përfshirjes, 25% Politikë të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rriturve Vulnerabël, 25% Politikë Displimore, 38% Politikë të Vlerësimit të Punës, 23% Politikë kundër Bullizmit dhe Ngacimit, 21% Politikë të Ankimimit, 13% Politikë të Shpërblimit, dhe 4% Politikë të Reduktimit. 10% thanë se kanë politika të tjera.

Treguesi 3.8.c: Pjesa e OSHC-ve që gjatë vitit të kaluar kanë publikuar vendet e lira për staf dhe vullnetarë.

Pyetjes nëse organizata ka publikuar vendet e punës për staf dhe vullnetarë, përgjigja ishte se kanale të ndryshme (komunikimi), mediat sociale dhe faqet e internetit janë përdorur më së shumti, nga më shumë se 40% të OSHC-ve. Portalet në internet janë përdorur nga më shumë se 37% e të anketuarve. Një nga gjetjet ishte se 16.7% nuk kanë përdorur ndonjë nga kanalet e mësipërme me arsyet që përfshijnë që nga problemet lidhur me pandeminë deri tek mungesa e vendeve të punës për shkak të mungesës së aktivitetit.

Treguesi 3.8.d: Pjesa e OSHC-ve që kanë politika organizative për rekrutimin e një fuqie punëtore të diversifikuar.

Përsa i përket politikave që inkurajojnë rekrutimin e një fuqie punëtore të larmishme, si politika të rekrutimit dhe përfshirjes së diversitetit, 21% e të anketuarve thanë se kanë politika të tilla.

Treguesi 3.8.e: Pjesa e OSHC-ve ku stafi dhe vullnetarët kanë ndjekur një kurs trajnimi në vitin e kaluar.

4 – plotëson shumicën e standardeve

79%

Pyetjes nëse organizata mundëson pjesëmarrjen e stafit dhe të vullnetarëve në kurse trajnimi për të rritur zhvillimin e tyre profesional, 79% e OSHC-ve thanë se i kanë mundësuar, ndërsa 18% thanë që nuk i kanë mundësuar.

BIBLIOGRAFIA

- Analizë e legjislacionit të Kosovës lidhur me filantropinë dhe OJQ-të, faqe 12-13, gjendet në: <https://fiqorg.com/wp-content/uploads/2020/05/ENG.Aanlize-legjislacionit-te-Kosoves-final-ENG-1-1.pdf>
- Raporti Vjetor 2021 për Financimin Publik të OSHC-ve. <http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/RaportiVjetor2021.pdf>
- Raporti Vjetor Financiar 2021, Ministria e Financave, Kosovë. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F25B154-2116-4D2D-96A4-25691600EA9D.pdf>
- CAF WORLD GIVING INDEX 2021. Charities Aid Foundation, <https://good2give.ngo/wp-content/uploads/2021/06/caf-ëorld-giving-index-2021.pdf> Shikuar me 8 Nëntor 2022.
- Regjistri Elektronik i OJQ: <https://ojq.rks-gov.net/Regjistrohu.aspx>.
- Raporti Vjetor 2021 i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në: http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2021/12/AnnualReport2021_eng_web.pdf Shikuar me 8 Nëntor 2022.
- Strategjia për Rininë 2019-2023. https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategy_for_Youth_2019-2023.pdf Shikuar me 8 Nëntor 2022.
- Western Balkan 2020 – Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development, available at: https://www.balkancsd.net/novo/ëp-content/uploads/2021/07/94-5-Regional-Monitoring-Matrix-Report-2020_FINAL.pdf

LISTA E LIGJEVE TË KONSULTUARA

- Udhëzimi Administrativ No. 02/2014 Për Regjistrimin dhe Funkcionimin e Organizatave Joqeveritare, Neni 18, gjendet në: <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/42849C56-2EA4-4D79-9175-40848137EE39.pdf>.
- Kushtetuta e Kosovës, 2008 gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
- Këshilli për Bashkëpunim midis Shoqërisë Civile dhe Qeverisë, gjendet në: <https://kryeministri.rks-gov.net/zyra-e-kryeministrit/keshilli-per-bashkepunim-te-qeverise-me-shoqerine-civile/>
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, gjendet në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>
- Draft Ligji 08/L-188 Për Tubimet Publike, gjendet në: <https://ëëë.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftLigji=406>
- Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2019-2023, gjendet në <https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Strategjia%20ne%20tri%20gjuhe.pdf>
- Ligji No. 03/L-040 Për Vetë-qeverisjen Lokale, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>.
- Ligji No. 03/L-118 Për Tubimet Publike, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2633>
- Ligji No. 03/L-145 Për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë, gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2654>. Shikuar me 8 Nëntor 2022.
- Ligji No. 05/L-028 Për Tatimin mbi të Ardhurat Personale, gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014> Shikuar me 8 Nëntor 2022.

- Ligji No. 06/L-022 Për Ndërmarrjet Sociale. gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18187>. Shikuar me 8 Nëntor 2022.
- Ligji No. 06/L-105 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20988&langid=2>. Shikuar me 8 Nëntor 2022.
- Ligji No. 06/L-43 Për Lirinë e Asociimit në OJQ, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>.
- Ligji No. 05/L-096 Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>
- Ligji Për Lirinë e Asociimit në OJQ-të, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>.
- Platforma për Financimin Publik të OSHC-ve, gjendet në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/lista-e-hollesishme/>
- Platforma për Konsultimet Publike në Kosovë, gjendet në: <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Docs/Doc-62bab617062c9.pdf>
- Rregullore No. 05/2016 Për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15036>
- Rregullore MF - Nr - 04/2017 Mbi Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve, gjendet në: https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/2018_rregullorja_MF_Nr_042016_per_perkrahje_te_OJQve_dhe_manuali.pdf
- Rregullore MF - Nr - 04/2017 Mbi Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Financimin Publik të OJQ-ve, gjendet në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/en/220-2/>
- Rregullore e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës no. 09/2011, gjendet në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/RREGULLORE-E-PUNES-SE-QEVERISE-SE-REPUBLIKES-SE-KOSOVES-NR-09-2011.pdf>